



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 QERSHOR 2015**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. JUNA 2015. GODINE**

**QERSHOR - JUNI
2015**

Rendi i ditës

Ndalimi në Slloveni i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, sipas një fletarrestimi të Serbisë

Dnevni red

Zadržavanje u Sloveniji predsednika Aleance za budućnost Kosova i poslanika Skupštine Kosova, Ramush Haradinaj, na osnovu poternice Srbije

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Para se të hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, më lejoni të theksoj se dje ka ndodhur një ngjarje jo e mirë, pasi njëri nga liderët politik në Republikën e Kosovës dhe ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është arrestuar në bazë të një urdhër-arresti të një shteti, të cilin as nuk e njohim, por në fakt e kemi luftuar gjatë periudhës së konfliktit 1998-1999.

Ne jemi jashtëzakonisht të interesuar të kemi raporte jashtëzakonisht të mira dhe t'i vazhdojmë raportet me shtetin e Republikës së Sllovenisë. Megjithatë, rasti që ka ndodhur për ne është i papranueshëm dhe realisht ka krijuar shqetësim.

Ndërkohë, e kemi marrë një mocion procedural nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

E kisha ftuar zonjën Kadaç-Bujupi që ta marrë fjalën.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 49, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës thërret seancë të jashtëzakonshme për çështjen në vijim:

Ndalimi në Slloveni i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, sipas një fletarrestimi të Serbisë.

A r s y e t i m

Është irritues, i papranueshëm dhe fyes për Kosovën dhe për të gjithë ne sjellja dhe veprimi i Policisë sllovene me udhëheqësin e njohur të luftës për lirinë e vendit, ish-kryeministrin e Kosovës dhe kreun e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Ramush Haradinaj.

Shteti slloven me sjelljen dhe veprimin e tij ndaj zotit Haradinaj bëri përjashtim me vendet e tjera të Bashkimit Evropian dhe sot u soll njëjtë si regjimet e së kaluarës në Beograd në raport me Kosovën dhe në raport me përpjekjet e pastra dhe të drejta të popullit tonë në të kaluarën për liri, për shtet dhe në raport me zotin Haradinaj që i përfaqëson vlerat si këto.

Ramush Haradinaj e dëshmoi disa herë veprën dhe veten e tij. Ai në të gjitha format e dëshmoi të vërtetën e krejt asaj çfarë ka bërë në të mirë të lirisë dhe në të mirë të shqiptarëve të Kosovës dhe në të mirë të së ardhmes sonë të përbashkët si qytetarë të Kosovës.

Ai këtë e dëshmoi më shumë se një herë edhe në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës. Gjithashtu, duke e parë të nevojshme që Sllovenia zyrtare duhet të reflektojë, ta lejojë sa më parë në këto momente dhe është tepër vonë që zoti Haradinaj ta vazhdojë udhëtimin e tij drejt Kosovës, të heqë dorë po ashtu nga këto praktika dhe të bëhet më në fund si të gjitha shtetet e Evropës, të

ndërhyjë në pastrimin sa më të shpejtë të këtyre listave nga reliktet e së kaluarës, nga mbeturinat, nga shpifjet dhe fletarrestimet e tilla, të cilat, pos në Beograd, ne dje e kuptuam se çuditërisht qenkan aktuale edhe në Lubjanë.

Si dhe duke e ditur që kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, po aq sa është i Kosovës, është edhe i bindjeve dhe i vizionit për një Evropë të lirë dhe të qytetëruar, kërkojmë nga ju, të nderuar kolegë deputetë, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që të procedojë me një seancë të jashtëzakonshme për këtë skandal që e shkaktoi shteti slloven, duke e goditur rëndë dhe duke e fyer Kosovën, shtetin tonë, vlerat dhe të gjitha ato që përfaqëson zoti Haradinaj.

Kjo do të ishte një sjellje konform përgjegjësi që ka Kuvendi i Kosovës, që kanë institucionet e këtij vendi në raport me zotin Haradinaj, por edhe me vetë imazhin e vet dhe vlerat që ka Kosova dhe për gjithë këtë ne duhet që çdo herë t'i i mbrojmë këto vlera të pacenueshme për veten, për Kosovën dhe për gjithë rajonin.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë ju thërras që së bashku ta thërrasim një seancë të jashtëzakonshme nëpërmjet së cilës do t'i nxjerrim rekomandimet dhe rezolutën, e cila do t'i obligojë institucionet përkatëse që këto veprime të mos përsëriten dhe këto praktika të ndalen. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkoj falje! Jemi në konsultim rreth çështjeve procedurale. Ju e vendosni në qoftë se do të kemi seancë të jashtëzakonshme nëpërmjet votimit, futemi menjëherë në seancë të jashtëzakonshme, e pastaj vazhdojmë me seancën e rregullt.

E kisha lutur regjinë dhe deputetët, meqë e kemi një propozim të zonjës Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duhet të përgatitemi për votim për një seancë të jashtëzakonshme, me temën ndalimi në Slloveni i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës të deputetit të Kuvendit të Kosovës, sipas një fletarrestimi të Serbisë.

A mund të përgatitemi për votim? Kush është për, kundër dhe abstenim? Në qoftë se jemi për, e na duhen mbi 40 vota, atëherë futet menjëherë në rend të ditës - seancë e jashtëzakonshme.

A jemi gati? Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë, i kemi 65 deputetë që kanë votuar, të gjithë janë për. Me vendimin tuaj, seanca e rregullt vazhdon pasi ta mbarojmë këtë pjesën e mocioni si seancë e jashtëzakonshme. Faleminderit!

Pikë e rendit të ditës së seancës së jashtëzakonshme është:

1. Ndalimi në Slloveni i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj, sipas një fletarrestimi të Serbisë

Urdhëroni, kush e dëshiron fjalën? Shaip Muja, urdhëro!

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot është vërtet një ditë, e cila në angazhimet e Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Kosovës për të qenë pjesë e familjes evropiane nuk është duke u trajtuar si pjesë e tillë, por është duke u eksperimentuar dhe duke e sjellë qytetarin e Kosovës, deputetin e Republikës së Kosovës si një leckë, e cila influencohet nga Republika e Serbisë me aktakuza të vjetra, të cilat janë të papranueshme.

Mënyra se si reagojnë institucionet e Kosovës është edhe më e turpshme, sepse në mënyrë shumë romantike dhe dëshpëruese reagojnë ndaj veprimeve të Qeverisë së Sllovenisë, duke mos e thënë asnjë fakt se pse u shkel e drejta e pasaportës diplomatike, pse u shkel e drejta e vizës së Shengenit. Nga një shtet i Shengenit, u shkel e drejta e Shengenit. Pse nuk respektohen raportet e të drejtave të njeriut, të cilat në dokumentacionin e vjetër, që ekziston sot, ne nuk kemi marrë asnjëherë një formë zyrtare, as nga Ministria e Drejtësisë, as nga Ministria e Punëve të Brendshme, që bën angazhimet për të qenë pjesë e Interpolit.

Thuhet se në Interpol janë 300 kosovarë. Nuk po them të amnistohen kosovarët me implikime kriminale me agjendat ndërkombëtare, por nuk mund të jenë në Interpol kosovarët të cilët kanë qenë të angazhuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Unë e di që ajo vlerë e angazhimit në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për Serbinë do të jetë gjithmonë e paharrueshme.

Mirëpo, nëse mendojmë që të bëjmë raporte në Bashkimin Evropian duke biseduar me qasje të tillë, jo për çështjen e zotit Ramush Haradinaj, por për çështjen e çdo deputeti, kjo tregon se ne nuk kemi asnjë vlerë, as si Parlament, as si Qeveri, e as si shtet, dhe mënyra e tillë të lutjes që sa më shpejt të lëshohet nuk duhet të respektohen, por duhet të udhëzohen.

Ne si deputetë duhet shumë shpejt që me Slloveninë ta shohim çdo ratifikim që e kemi bërë deri më tani. Ato ratifikime t'i rishikojmë dhe t'i anulojmë të gjitha, një nga një, dhe në këtë seancë kërkoj të sillen të gjitha ratifikimet që janë bërë me shtetin e Sllovenisë.

Tjetra? Nëse Vuçiq e di që Ramush Haradinaj paska lëvizur 50 herë me pasaportë diplomatike, do të thotë e paskan survijuar 50 herë, e në 50-tën kanë thanë 'hajde ta burgosim, se po bëjmë një lloj eksperimenti'. për qëllime, të cilat ne nuk i kemi të shpjegueshme. Dhe, ne si deputetë të Republikës së Kosovës duhet t'i ngrijmë të gjitha raportet dhe të organizohemi që ta bëjmë një aktakuzë te kryeprokurori i Republikës së Kosovës e t'i paditim në institucionet e Republikës tonë zotin Vuçiq, zotin Daçiq dhe zotin Nikoliq si vrasës, si pjesëmarrës në vrasje, si fshehës të fakteve të 1 600 viktimave që nuk i dorëzojnë dhe luajnë me disa viktime, për të cilat ende nuk dihet adresa e saktë e viktimizimit dhe e trajtimit që i bëhet Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Një notë proteste duhet ta ngremë edhe në Bashkimin Evropian, sepse shteti i Bashkimit Evropian, që në këtë rast është Austria, i lëshon vizë Shengen qytetarit të Republikës së Kosovës dhe i thotë që i plotëson të gjitha kushtet, ndërsa në të njëjtën kohë shteti tjetër i Shengenit i Bashkimit Evropian, që është Sllovenia, thotë se kjo vizë nuk është valide dhe e ndalon madje edhe me arrestim.

Po të mos kishte pjesë politike zoti Ramush Haradinaj, me atë akuzë ai sot do të ishte në burg. Prandaj, nuk po flitet këtu për problemin e Haradinajt, por për problemin e qytetarit të Republikës së Kosovës, se në çfarë mënyre i trajtojnë qytetarët tanë dhe kush mund të trajtohet në atë mënyrë? Çdo kush nga ne.

Të ndërpriten të gjitha bisedimet me Bashkimin Evropian për stabilizim-asociimin dhe për marrëveshjet me Serbinë, derisa të mos qartësohen çështjet e Interpolit.

Ministri i Punëve të Brendshme para disa ditësh tha ‘ne po bëjmë qasje të angazhohemi në Interpol’. Mirëpo, Interpoli nuk mund t’i trashëgojë listat e vjetruara, të cilat janë nga ish-regjimi, i cili është quajtur kriminal, gjenocidal dhe tash nga ato lista të jenë të ekspozuar qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe, e ftoj çdo qytetar të Republikës së Kosovës, se unë vetë personalisht kam relacione ekonomike me Republikën e Sllovenisë, nga sot e tutje do t’i shkëpus të gjitha relacionet me atë republikë.

Ata duhet ta dinë se nuk mund të lëvizin në interesat personale, sepse nëse bëjnë biznes më shumë me Serbinë, ne jemi shtet më i vogël dhe nuk kemi nevojë për interesa të disa individëve, të disa politikanëve tanë, që kanë gjetur rehati në shëtitje në Slloveni. Dhe, mundësisht mos udhëtoni askush me “Adria Airlines” me të afërmit e juaj, u thoni të fillojnë t’i bojkotojnë. Nuk kemi nevojë ne t’u bëjmë shërbimet, me të cilat qytetarët e Republikës së Kosovës mund të trajtohen në mënyrë të tillë.

Po ashtu, të gjithëve ju ftoj t’i dorëzoni pasaportat diplomatike. Këto pasaporta nuk kanë asnjë vlerë nga ne që i mbajmë, sepse kjo pasaportë s’ka kurrfarë benificioni, përveç honorifik. Duhet të shkosh ta vësh vizën dhe unë e kam sjellë me vete, e do t’ia dorëzoj kryetarit të Parlamentit këtë pasaportë, i them ta mbajë, sepse nuk kam nevojë për të. Më mirë duhet ta izolojmë vetveten, sesa të na izolojnë të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muja, emocionaliteti juaj! Kalojmë te shefat e grupeve parlamentare, për arsye se më herët nuk qenë të paraqitur. Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin,

Kabinetin qeverisës,

Për të gjithë deputetët,

Ne si grup parlamentar vërtet ndajmë shqetësimin me të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm me deputetët e Kuvendit, sepse rasti që i ka ndodhur zotit Haradinaj, i cili nuk është i pari dhe i vetëm, me provokime të tilla, mbi bazën e fletë-ndjekjeve të së kaluarës, që të gjithë e dinë që janë të padrejta, ne e ndajmë këtë shqetësim me të gjithë qytetarët e vendit dhe kërkojmë që këto praktika vërtet të ndërpriten.

Është befasuese dhe shqetësim shumë i madh yni, pikërisht kur kemi parasysh se kemi të bëjmë me një shtet mik, me një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, me një shtet me të cilin kemi pasur raporte të mira, dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Adem, vazhdo! Regjia, të lutem!

ADEM GRABOVCI: ...kemi të bëjmë vërtet me një provokim të rëndë dhe aq më tepër kur i kemi parasysh proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë, rasti i tillë është edhe një provokim i rëndë, i cili po u bëhet të gjitha institucioneve, shtetit dhe qytetarëve të Kosovës dhe po e rëndon jetën tonë, edhe ashtu të rënduar.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ne kërkojmë angazhimin serioz të të gjitha institucioneve të vendit tonë që këto praktika vërtet të ndërpriten njëherë e përgjithmonë. Listat në të cilat figurojnë mbi 300 qytetarë të Republikës së Kosovës me akuza të pabaza e të pavërteta, të pastrohen dhe kjo praktikë të ndërpritet njëherë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kërkoj falje zoti Grabovci që jua ndal fjala! Zoti Beqiri, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Qeveri,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që të gjithë ne si deputetë të këtij Kuvendi edhe grupi ynë parlamentar ndajmë shqetësimin me të gjithë qytetarët e Kosovës për atë që ndodhi dje, për ndalimin e zotit Haradinaj nga autoritetet sllovene, dhe një veprim të tillë e vlerësojmë si të papranuar dhe të padrejtë. Ndalimi i zotit Haradinaj, një ish-ushtari të UÇK-së, kryetar partie dhe aktualisht deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, bazuar në një fletarrestim të lëshuar nga shteti serb, është veprim që, deshëm apo nuk deshëm, dëmton raportet tona me një shtet që kemi vlerësuar dhe vlerësojmë se ka qenë korrekt, së paku karshi Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës në momentet e rënda.

Ndalimi i zotit Haradinaj në një mënyrë e dëmton këtë opinion dhe bindjet e qytetarëve tanë dhe të Kosovës për shtetin slloven. Ne dëshirojmë të besojmë dhe besojmë se sikur disa nga autoritetet sllovene nuk mendojnë qytetarët sllovenë dhe nuk sillen në këtë mënyrë të papërgjegjshme karshi një autoriteti, siç është deputeti në këtë rast Haradinaj, dhe ne si grup parlamentar kërkojmë që zoti Haradinaj të lejohet sa më shpejt, përkatësisht menjëherë të kthehet në Kosovë.

Po ashtu, autoritet dhe njerëzit kompetentë tanë kërkojmë që konform përgjegjësisë që kanë t'i ndërmarrin masat e nevojshme që kjo situatë të zgjidhet dhe që diçka e ngjashme të mos ndodhë në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,

Ndalimi i djeshëm i Ramush Haradinajt nga Policia sllovene në Aeroportin e Lubjanës është një akt i papranueshëm, i cili nuk ka të bëjë vetëm me zotin Haradinaj, por me shtetin e Kosovës si të tillë.

Ndalohet Ramush Haradinaj, komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kryetar i AAK-së, ish-kryeministër i Kosovës dhe deputet i Kuvendit, të cilit i konfiskohet pasaporta sipas një fletarrestimi të Serbisë. Ky fletarrestim ishte në kuadër të veprimeve të Serbisë të vitit 2004 dhe shtrohet pyetja: Pse pikërisht në vitin 2004? Në vitin 2004, sepse në atë kohë zotit Haradinaj po i përgatitej një proces gjyqësor nga Gjyqi i Hagës dhe Serbia doli me fletarrestim për zotin Haradinaj për të thënë që ajo ishte që po e bënte në të vërtetë procesin gjyqësor ndaj zotit Haradinaj, e jo Gjyqi i Hagës.

Pra, që të krijohej përshtypja se pikërisht për shkak të fletarrestimeve të Serbisë po gjykohej dhe po persekutohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Kjo është arsyeja pse Serbia në vitin 2004 lëshoi fletarrestim për zotin Haradinaj. Por, zoti Haradinaj nuk shkoi në Hagë për shkak të këtij fletarrestimi, po shkoi atje vullnetarisht dhe të mos harrojmë - doli i pafajshëm nga procesi gjyqësor i Hagës.

Mirëpo, kjo që ndodhi nuk mund ta amnistojë as Qeverinë e Republikës së Kosovës. Pse? Çfarë është kjo Qeveri jona, e cila nuk po e di, apo nuk i rregullon këto çështje me shtetet e rajonit? Të mos harrojmë, nuk është hera e parë që po na ndodh. Prej vitit 2004, kjo çështje po ndodh për herë të tretë me ish-kryeministrin Çeku, me deputetin Limaj, tashmë me ish-kryeministrin Haradinaj. Nëse ndodh një proces tri herë, ku janë institucionet të cilat nuk po interesohen që t'i rregullojnë këto çështje dhe të shohin se cilat fletarrestime janë aktive, në cilat shtete është ende rrezik që të shkojë një deputet i Kosovës, të kalojë nëpër territorin e saj, sepse mund të përfundojë i arrestuar, mund t'i konfiskohet pasaporta, edhe pse ajo është diplomatike.

Ne kërkojmë nga Qeveria sllovene lirimin e menjëhershëm dhe të pakusht të Ramush Haradinajt, si dhe anulimin pa diskutim të vlefshmërisë të fletarrestimeve të Serbisë ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Por, një gjë që dua them se është keq që Sllovenia e ka bërë këtë gjë, por të mos i biem në qafë Sllovenisë më shumë se Serbisë. Kjo është shumë e rëndësishme. Pse? Sepse, Sllovenia këtu është vetëm pasoja. Problemi i vërtetë politik dhe pse kjo në të vërtetë po ndodh është shteti i Serbisë, e jo Sllovenia.

Pse po e them këtë? Sepse, kemi dëgjuar shumë reciprocitet këtu në Kuvend, edhe nga Qeveria për Slloveninë, reciprocitet për Bosnjë-Hercegovinën, por nuk kam dëgjuar kurrë në këtë Kuvend dhe nga Qeveria reciprocitet përnjëmend ndaj shtetit të Serbisë. Kjo është ajo që na duhet më së shumti dhe prej kësaj duhet të fillojmë, se disi reciprociteti ndaj Sllovenisë po na duket si kollaj se nuk ka kurrfarë rreziku prej Sllovenisë. Sllovenia larg disi atje dhe nuk jemi në negociata me të, kështu që po jemi shumë të ashpër me njëfarë komoditeti shumë të kollajshëm, por këto fjalë na vyejnë në të vërtetë ndaj Serbisë. Serbia është ajo, e cila i ka lëshuar këto fletarrestime për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe me Serbinë po shkoni atje në Bruksel e po thoni 'kemi marrëdhënie shumë të mira dhe duam ta trashim miqësinë'.

Tregojeni reciprocitetin dhe vendimet e ashpra reciproke më së pari duke ia vënë kusht Serbisë që t'i anulojë këto fletarrestime ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E ky do të ishte hapi i parë në drejtim të një reciprociteti të vërtetë, e ky reciprocitet le të shkojë drejt njohjes të shtetit të Kosovës nga Serbia, t'ia vendosni si kusht ndryshimin e Kushtetutës të Serbisë, shuarja e strukturave të paligjshme të Serbisë brenda territorit të Kosovës e kështu me radhë. Kjo na duhet para se gjithash. Kur të ndodhë kjo, besoni që nuk do të kemi problem as me Slloveninë, as me asnjë shtet tjetër, sepse kur Serbia i heq këto fletarrestime së pari, të gjitha shtetet tjera do të shkojnë pas kësaj dhe nuk do të kemi kurrfarë problemi.

Çfarë bëri Qeveria e Kosovës? Unë mendoj që reagimi i saj ka qenë i dobët. E kemi pas një reagim, i cili ka qenë shprehje e pakënaqësisë. Shprehje të pakënaqësisë mund të bëjnë qytetarët e thjeshtë, mund të bëjnë shoqatat joqeveritare, e mbajnë një konferencë dhe të gjithë e shprehin pakënaqësinë tonë ndaj kësaj që ndodhi. Qeveria është për të bërë veprime konkrete. Këtu, prej veprimeve konkrete më e pakta që do të duhej të kishte ndodhur është një notë proteste, që t'i drejtohet shtetit të Sllovenisë, sepse me këtë është cenuar sovraniteti i shtetit të Kosovës. Pse kur preket një deputet, cenohet sovraniteti i shtetit të Kosovës? Sepse, po e citoj Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në njërin prej neneve të saj, thotë: "Ushtrues të sovranitetit shtetëror janë të zgjedhurit, përfaqësuesit e popullit", pra deputetët e Kuvendit. Ne jemi bartës të sovranitetit shtetëror. Kështu e definon Kushtetuta e Kosovës sovranitetin shtetëror, sepse jemi përfaqësues të popullit.

Dhe, në këtë mënyrë është prekur drejtpërdrejt sovraniteti i shtetit të Kosovës kur ndalohet, keqtrajtohet, trajtohet në mënyrë të padinjitetshme një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke ia konfiskuar edhe pasaportën diplomatike dhe duke i thënë që tash duhet të paraqitesh në gjykatë dhe duhet të kalojnë të gjitha procedurat e veçanta.

Pra, ne kërkojmë kthimin e menjëhershëm të Ramush Haradinajt në Kosovë, kthimin e pasaportës diplomatike dhe që Qeveria e Kosovës të jetë aktive në këtë drejtim, dhe së paku t'ia drejtojë një notë proteste shtetit slloven.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Lekaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në emër të Grupit Parlamentar, e ka fjalën.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit të Republikë së Kosovës!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovë,

Qytetarë të nderuar,

Dje në Lubjanë, në shtetin slloven, është ndaluar padrejtësisht një qytetar i Kosovës. Dje, në Lubjanë është ndaluar padrejtësisht deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ish-kryeministri, ish-luftëtar i lirisë dhe njeriu që ka kontribuar për të mirën e vendit, për të mirën e rajonit, për paqen në rajon. Dje, në Lubjanë është bërë një tallje me shtetin e sapoformuar, që quhet Republika e Kosovës.

Është një tallje nga shteti slloven me institucionet e Republikës së Kosovës. Është një tallje me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Është një tallje me Presidenten e Republikës së Kosovës. Deri kur kështu rajoni do ta trajtojë qytetarin e Kosovës, deputetët e Kosovës, institucionet e

Kosovës dhe deri kur me këto ndalesa të padrejta? Zoti Haradinaj i ka kryer të gjitha obligimet ndërkombëtare, edhe si qytetar, edhe si ushtar, edhe si ish-kryeministër, edhe si njeri i paqes dhe i vlerave të kombit.

Prandaj, mendoj që nga ky vend ne ta ftojmë Republikën e Sllovenisë që pa asnjë kusht të lirohet zoti Haradinaj, që pa asnjë kusht të pastrohet njëherë e përgjithmonë ajo listë që trajton padrejtësisht luftëtarët e lirisë me shpifje nga shteti i Serbisë.

Dhe, ky Kuvend ta tregojë aftësinë e veprimit institucional e shtetëror që asnjë shtet të mos bëjë lojëra me shtetin e Republikës së Kosovës, sepse nëse fillojnë kështu, mendoj që qytetarët do ta thonë të veten. Nëse ne si institucione nuk veprojmë, qytetarët do të veprojnë dhe të mos lejojmë si institucione, si deputetë, si Qeveri dhe Presidentja e Kosovës, të ushtrojnë kompetencat e veta dhe t'u tregojë shteteve në rajon që ne jemi për paqe, por në asnjë mënyrë nuk guxojnë që të tallen me deputetët tanë, me deputetët dhe me shtetin tonë.

Prandaj, lus nga ky vend që ky Kuvend t'i nxjerrë konkludimet që sot zoti Haradinaj të kthehet sa më parë në Kosovë, t'i kthehet familjes dhe të mos mbahet padrejtësisht dhe askush të mos prekë në dinjitetin e një luftëtari, një ish-kryeministri, një qytetari të Kosovës.

Dhe, kjo është kërkesa jonë dhe po qe se nuk ndodh kjo, ne nuk do t'i bartim pasojat që do të veprojnë qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Lekaj! Zoti Berisha, nga Grupi Parlamentar "Nisma", e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar kolegë deputetë,
Kryetar i Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Ramushi shpeshherë po bëhet arsye për debate emocionale.

Në fakt, çështja e ndalesës së Ramushit është kulminacioni i vazhdimësisë së politikës agresive të Serbisë, vazhdimi të politikës agresive të Serbisë, me dosje të regjimit fashist dhe servilitetit të skajshëm të institucioneve të Kosovës, karshi këtij agresiviteti serb.

Ramush Haradinaj, në fakt, është ndalur pas shumë ndaljeve të tjera, mirëpo reputacioni i tij, pozita e tij edhe si deputet edhe si udhëheqës i luftës na bën që ne të debatojmë dhe jo të lutemi, jo të kërkojmë lutje nga Serbia "aman, lëshojeni Ramushin!" Ne kemi qytetarë që ndalohen në shumë vende të Evropës. Unë tash sa jam kthyer.

Domethënë, në aeroporte kalon me shumë rreziqe. S'ka gjysmë ore që jam kthyer prej Perëndimit. Kemi qytetarë që janë ndalur në Francë, janë ndalur në Zvicër... kemi qytetarë që janë ndalur në Shqipëri, në Morinë, janë ndalur, me dosje të Serbisë, por ne nuk e kemi bërë të madhe.

Rasti i Ramushit, unë mendoj se është moment që ne si Parlament t'ua rikthejmë imunitetin që ua morën në mandatin e kaluar deputetëve, për t'ia kthyer imunitetin edhe pasaportës diplomatike, përndryshe nuk e di pse e bartim atë.

Unë mendoj, se ky Kuvend duhet të nxjerrë rezolutë për këtë çështje. Pas këtyre fjalimeve, grupet parlamentare të merren vesh dhe rezolutë e cila obligon Qeverinë e Kosovës. Ministri i Jashtëm është dashur automatikisht dje, kur unë u nisa në Gjenevë e mora vesh këtë lajm, është dashur notë proteste Sllovenisë.

Është e vërtetë, Sllovenia është një nga shtetet mike të Kosovës, por ajo zbaton ligjin. Sllovenia e ka pasur për afërsisht fatin e përbashkët me Kosovën. Kemi qenë aleatë ndaj regjimit fashist të Serbisë së Milosheviqit. Mirëpo, unë mendoj se neglizhenca e qeveritarëve të Kosovës, ka bërë që edhe deputetët edhe qeveritarët të ndjehen të pasigurt në vendet e Bashkësisë Evropiane.

Një rezolutë e cila do të jetë obligative për Qeverinë e Kosovës dhe të gjitha institucionet, përndryshe, në nëse vazhdojmë kështu, mendoj se ky është fillimi i eksperimenteve që bëhet me qytetarët e veçanërisht me luftëtarët.

Kosova, për fat të keq, vazhdon të mbetet “laborator eksperimental” me njerëz. Në kohën kur në vende tjera bëjnë eksperimente në laboratorë e me kafshë të tjera, në Kosovë, bëhet për fat të keq, po e përsëris, me njerëz. Dhe, Glauku e tha në njëfarë forme, kush ka dashur ta kuptojë, nuk është krejt edhe e rastit.

Unë do ta shfrytëzoj edhe momentin, të nderuar kolegë deputetë. Jemi para një momenti historik. Në rast se e votojmë Gjykatën Speciale, dijeni që për çdo ditë ky Parlament do të ketë... disa që janë këtu jo, sepse do të jenë nëpër burgje, por ata që do të mbeten, do të kenë këso debatesh e këso lutjesh, “aman, duman...” në raport me institucionet.

Përfundimisht, unë llogaris veten si qytetar i shqetësuar, si deputet i një shteti që është përkulur skajshmërisht ndaj Serbisë dhe meqë nuk e kam ngritur flamurin e bardhë në asnjë moment, edhe në këtë kohë do të rezistoj. Përndryshe, e vërteta do të dalë në shesh, gjithqysh bëhet shteti, vetëm kështu siç jemi duke punuar nuk bëhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Berisha! Duda Balje, nga “6+”, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Vest o jučerašnjem hapšenju gospodina Haradinaja potresla je i mene i sve članove moje grupe jednako isto, kao i sve kosovare.

Ono što želim da naglasim sada, je da ovakva vrsta hapšenja kao što je, čuli ste verovatno pre par dana, i hapšenje gospodina Naseri Orlića, to su osobe koje su definitivno dale doprinos da države čiji su oni bili članovi budu ovakve kakve jesu sada, predstavlja sad možda neku vrstu fenomena.

Iskreno se nadam da će Republika Slovenija brzo shvatiti da je napravila grešku, bez obzira poštujući zakon ili ne, i da će našeg poslanika i građana Kosova što pre osloboditi i nadam se da se ovakve stvari više neće dešavati. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Lista serbe, Slobodan Petroviqi e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem, predsedniče!

Poštovani premijeru,

Članovi Vlade,

Uvaženi kolege narodni poslanici,

Razumemo zabrinutost i iz tog razloga smo i mi dali glas za ovu vanrednu sednicu.

Mi svakako delimo zabrinutost iz razloga što nas čekaju procesi koji su ispred nas, pre svega mislim na formiranje specijalnog suda i sve ono što je ispred nas je svakako da ovakvi događaji nas na neki način udaljavaju od toga i unose nepotrebnu tenziju.

Svakako da smo i mi za rešenje, koje će da unese mir naših građana i svih drugih građana i ne bih želeo da se bavimo teorijama zavera i da iz ovog izađemo još nezadovoljniji i još nervozniji. Pa bih uputio jedan apel da je jako važno i retoriku sa kojom se mi ovde koristimo da budemo hladne glave, jednostavno ja prosto sam svestan činjenice da je ovo pogotovu za bliske prijatelje i članove AAK, momenat koji ih uznemirava ali ja bih i sa ovog mesta apelovao na sve druge da još više ne ulazimo u neke procese, koji bi nam otežale i ovako tešku situaciju.

Mi smo svakako deo ovog društva i da želimo da svi zajedno imamo jednu mirnu i sigurniju i današnjost i budućnost i iz tog razloga želimo da naša uloga bude u tom pravcu i da samo tako gledate našu ulogu. Nikad se nismo radovali tuđoj nesreći, pa se ne radujemo ni danas. Još jednom vas molim da to shvatite na taj ljudski način.

Razumemo situaciju, razumemo zabrinutost, delimo zabrinutost, ali je još gore ukoliko iz ovog izađemo sa težom situacijom, ukoliko još više ugrozimo naše prijatelje i partnere koje imamo po i okruženju i po svetu.

Znači, još jednom kažem, mi smo dali glas za ovu vanrednu sednicu iz razloga jer razumemo zabrinutost i želimo da se ovo što pre reši, pogotovo što, još jednom naglašavam, da nas čekaju jako teško i izazovne nedelje ispred nas. Pre svega mislim na ono što svi znamo, formiranje Specijalnog suda, što je nešto što se dugo priča unazad i sigurno da ovakve stvari nam umanjuju ohrabrenje da ćemo da završimo taj proces.

Još jednom se najiskrenije zahvaljujem na pažnji.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Petroviq! Tani fjalën e ka paraqitësja e mocionit, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përsëri zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të grupeve parlamentare,

Duke ju falënderuar për përkrahjen dhe prezantimet e juaja, mendoj që në këtë moment derisa ne po vazhdojmë me këtë debat, zoti Haradinaj po vazhdon të mbahet në Slloveni. Edhe më tutje nuk po lejohet që të kthehet në Kosovë, prandaj është e nevojshme që ne përtej fjalëve, të kalojmë në veprime konkrete, në kuptimin e daljes si Kuvend me një rezolutë të menjëhershme,

e cila do t'i thërrasë dhe obligojë institucionet përkatëse, që përtej fjalëve të ndërmarrin veprime që do të bëjnë që zoti Haradinaj brenda orësh të jetë në Kosovë.

Unë ju thërras dhe kërkoj për mirëkuptim, që të kemi 10 minuta pushim, në mënyrë që të harmonizohemi si grupe parlamentare me rezolutën e cila do të dalë nga ky vend dhe, edhe njëherë, kërkoj përkrahjen e të gjithë deputetëve, që kjo rezolutë të jetë e votuar unanimisht. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Kemi një propozim nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, fjalën e ka zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet këtë propozim dhe edhe ne kërkojmë që vërtet bashkërisht t'i harmonizojmë qëndrimet tona dhe të dalim me një rezolutë, e cila do ta obligojë shtetin slloven, që sa më parë zoti Haradinaj të kthehet në Kosovë. Falemnderit!

KRYETARI: Ta kemi parasysh, ne flasim vetëm për institucionet tona, s'mund obligojmë shtetet tjera. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Vetë fakti që ne pranuar dhe e ndjemë të gjithë obligim që ta kemi këtë seancë të jashtëzakonshme, kjo nënkupton edhe atë që pajtohemi që ta kemi këtë pauzë dhe t'i harmonizojmë rekomandimet për një rezolutë që do ta nxirrte ky Kuvend. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne pajtohemi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të dalë me një rezolutë, e cila do të përmbante një minimum veprimesh, të cilat do të ishin obligative për Qeverinë e Republikës së Kosovës, se si të veprohet në këtë rast dhe se çfarë raportesh të kemi me shtetin e Sllovenisë, në përgjithësi.

Pra, na duhet një pauzë prej dhjetë minutash në fund që t'i harmonizojmë qëndrimet tona dhe të dalim me këtë rezolutë.

KRYETARI: Falemnderit! Zoti Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

I mi se slažemo sa predlogom koleginice Donike, da treba da idemo na pauzu i da usaglasimo naše stavove oko izrade tih preporuka. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Falemnderit!

Për vetë faktin që e pata idenë për të dalë ky Kuvend me një rezolutë, besoj se do të jap edhe kontributin në këtë drejtim, jo për ta kushtëzuar Slloveninë, por për t'i kushtëzuar institucionet e Kosovës, në raport me përgjegjësitë që kanë për deputetët dhe qytetarët. Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: I parlamentarna grupa “6+”se slaže sa predlogom i daćemo svoj doprinos u tekstu rezolucije. Hvala!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, atëherë kemi pauzë deri në orën 11:20.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Ju kërkoj falje, veçanërisht mediave, se thamë do të vazhdojmë në orën 11:20, e tash është ora 12:05.

A e kemi të harmonizuar tekstin e projektrezolutës? Donikë, fjala është për ju.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit të nderuar kolegë deputetë,

Grupe parlamentare,

Për diskutimin konstruktiv dhe bashkërendimin në këto veprime të rëndësishme.

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, i propozojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në mbledhjen plenare të ditës së sotme të miratojë këtë

R E Z O L U T Ë

1. Qeveria dhe presidentja e Kosovës urgjentisht të kërkojnë nga autoritetet sllovene që deputetët të Kuvendit të Kosovës, ish-kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, tani deputet, zotit Ramush Haradinaj, pa asnjë kusht dhe menjëherë t’i kthehet pasaporta diplomatike dhe t’i lejohet kthimi në Kosovë.

2. Qeveria e Kosovës të kërkojë urgjentisht nga Brukseli pastrimin e menjëhershëm të listave, respektivisht të fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia për ish-ushtarët e UÇK-së, dhe

3. Drejtimi i notës së protestës shtetit slloven nga institucionet e Kosovës.

Unë ju thërras që bashkërisht ta votojmë këtë rezolutë dhe ju falënderoj për përkrahje.

KRYETARI: Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të gjithë e kemi përcjell me shqetësim ndodhinë e djeshme të ndalimit të deputetit Haradinaj në Lubjanë të Sllovenisë, pas një udhëtimi zyrtar në Gjermani, që ishte transit në Slloveni, për t'u kthyer në Kosovë dhe ajo që dëshiroj të theksoj është se menjëherë të gjitha autoritetet e shtetit të Kosovës duke u nisur nga presidentja, kryeministri, Ministria e Jashtme, ministri i Drejtësisë, kemi vërë kontakte me autoritetet më të larta të shtetit të Sllovenisë, kemi vërë kontakte me autoritetet më të larta të Bashkimit Evropian dhe të miqve e partnerëve tjerë që kjo çështje të zgjidhet shpejt dhe drejt.

Të gjithë jemi dëshmitarë të një liste të emrave me aktakuza të kohës së Sllobodan Milosheviqit, që janë ripërtërirë edhe në vitin 2004 dhe 2006 në kohën e kryeministrit Koshtunica, që ka qenë i njëjti mentalitet dhe e njëjta logjikë.

Ajo që dje ka ndodhur ka ndodhur edhe me zyrtarë të tjerë të institucioneve të Republikës së Kosovës, ka ndodhur edhe me mua personalisht po në atë vend, edhe në Lubjanë, ka ndodhur edhe në Budapest, por i ka ndodhur edhe ish- kryeministrit Çeku, dy-tri herë, po në atë vend dhe vende tjera në Bullgari apo edhe në vend tjetër, që nuk po më kujtohet, e gjithashtu edhe deputetit Limaj dhe tash i ripërsëritet zotit Haradinaj.

Natyrisht se ky fenomen është shqetësues. Jemi angazhuar maksimalisht me gjithë autoritetet ndërkombëtare që kjo çështje të tejkalohet dhe të zgjidhet një herë e përgjithmonë, dhe kjo çështje nuk zgjidhet një herë e përgjithmonë në raportet bilaterale të Kosovës me një shtet të veçantë, por zgjidhet drejtpërdrejt nga autoritetet e Brukselit – të Interpolit.

Për këtë arsye jemi duke punuar maksimalisht me gjithë potencialin tonë që e kemi si shtet që të anëtarësohemi sa më shpejt në Interpol.

Pajtohem me Rezolutën dhe ka pasur mundësi t'i shtohet edhe diçka tjetër, në veçanti duke u drejtuar autoriteteve të Brukselit, por dua të vlerësoj atë se Sllovenia edhe me këtë ndalesë, edhe me ndalesën që e ka bërë ndaj meje, ndaj Çekut, ndaj Limajt, nuk ka vepruar as ndaj Haradinajt, as ndaj Thaçit, as ndaj Çekut, as ndaj Limajt, personalisht apo si ish- kryeministra, ish-ministra, ish-deputetë, apo kundër Kosovës.

Sllovenia është një nga shtetet më mike që e kemi pasur në kohët më të rënda për Kosovën.

Është tash çështje tjetër atje procedurale të kompjuterëve të tyre, që ulet një polic aty dhe i dalin emrat e fletë-arresteve dhe detyrohet të veprojë.

Është veprim i pajustificueshëm plotësisht. Flas edhe në rrafshin personal, edhe në rrafshin e përgjegjësisë institucionale që e kam pasur edhe si ish-kryeministër, por edhe sot si zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm. Prandaj, në asnjë rrethanë, edhe ky incident krejt i pajustificueshëm, i papranueshëm, nuk duhet të ndikojë në raportet tona bilaterale të shkëlqyera me Slloveninë.

Pra, ne duhet në rrafshin e institucioneve të shtetit të Kosovës, këtë çështje ta diskutojmë edhe

më seriozisht, në mënyrë edhe më të përgjegjshme, edhe në takimet që mund t'i kemi në të ardhmen e afërt në Bruksel dhe të zgjidhet një herë e përgjithmonë. Unë dëshiroj t'ju falënderoj edhe për mirëkuptimin! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në princip, ne e kemi një projektrezolutë, të cilën duhet ta hedhim në votim. Po e shoh të rëndë një element, në qoftë se është keqpërdorim, dhe unë do të dal në foltore para se ta aprovojmë dhe do ta kisha mbajtur një qëndrim si deputet para aprovimit, në qoftë se më lejoni.

Nuk do të hy në debat, por është çështja të bëhet notë proteste për diçka se si shtet juridik ka obligime me marrëveshje ndërkombëtare, siç është Interpoli, mos po e tejkalojmë çështjen e kompetencave të cilat i ka Republika e Sllovenisë. Megjithatë, është shtet juridik dhe sido që të jetë, ne mund ta bëjmë, por të jemi serioz me të vetveten për arsye se nesër mund të na ndodhë edhe me një shtet që na ka njohur, t'ju prishim raportet me miqtë tanë.

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Fjalën e ka edhe një herë zëvendëskryeministri, e ne do të vazhdojmë me votim dhe kërkoj falje nëse është keqpërdorim i foltores, por po më duket e rëndë me shtet mik. Urdhëro, zëvendëskryeministër.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Nuk mendoj se është keqpërdorim i foltores, aq më tepër që flasim për këtë çështje dhe është mirë që bashkërisht të punojmë për ta zgjidhur një herë e përgjithmonë. E mira do të ishte që ajo rezolutë t'ju shpërndahej të gjithë deputetëve dhe ta lexojnë. Të gjithë pajtohem, por natyrisht, mund të kemi dallime në nuanca formulimi.

Nuk është çështja vetëm me Slloveninë. Unë, atë ditë, në drejtime të ndryshme, në të njëjtën kohë kemi udhëtuar së bashku me zotin Haradinaj nga Aeroporti i Prishtinës, ai në drejtim tjetër, unë në drejtim tjetër. Por, të njëjtat lista i ke edhe në Morinë, në hyrje në Shqipëri. Po, po kështu është e Shqipëria është pjesë e NATO-s, është pjesë e Interpolit.

Çka nëse na ndodh nesër në Morinë? Disa prej juve këtu nuk flasin, por e dinë gjithmonë që sa herë edhe që shkojnë në Shqipëri, u lajmërohen autoriteteve të Shqipërisë për të kaluar më lehtë, për të mos i ndalur.

Ky është realitet, dhe ne duhet të diskutojmë shumë hapur. Çka nëse dikush, ndonjë deputet ndalet në Morinë, me ndonjë lëshim, gabim apo respektim të vendit të punës, përgjegjësiye kushtetuese dhe ligjeve të Shqipërisë, e tash, ne a të prishemi edhe me Shqipërinë, a?!

(Ndërhyrje)

Po ngadalë. Kjo është çështje kushtetuese, ligjore dhe përgjegjësi shtetërore, jo më emocionale, Donikë, krejt. Unë po flas me përgjegjësi shtetërore, jo në kuptimin emocional, sepse unë jam ndalë dy-tri herë, s'je ndalë ti.

Prandaj, unë mendoj se duhet të kemi kujdes në formulimet tona, në rezolutat tona, në dokumentet tona shtetërore ndaj shteteve përkatëse, e veçanërisht ndaj shteteve mike që na kanë mbështetur fuqishëm.

Unë jam në favor të një rezolute, por të jetë një rezolutë vërtet e përgjegjësive shtetërore dhe jo e donimit emocional. Faleminderit!

KRYETARI: Donika e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,
Kjo projektrezolutë është harmonizuar me të gjitha grupet parlamentare dhe e kemi përgatitur bashkërisht, si deputetë dhe si përfaqësues të grupeve parlamentare dhe të subjekteve politike.

Ndërhyrja e Qeverisë në projektrezolutë është e papranueshme. Qeveria, nëse kjo rezolutë kalon, është e obliguar që ta zbatojë si të tillë, sepse jemi një Republikë parlamentare.

E dyta, gjuha e përdorur në këtë rezolutë është shumë më e butë se veprimet të cilat po bëhen kundruall liderëve të Kosovës, jo vetëm në Slloveni, por edhe në shtete të tjera.

Prandaj, kërkoj që bashkërisht, ashtu siç e harmonizuaam këtë rezolutë, të paktën një herë të veprojmë si shtet, të dalim nga ai mentaliteti i së kaluarës kur gjithmonë jemi lutur për të drejtat tona dhe të kalojmë në veprime konkrete dhe të sillemi konform ligjeve, konform Kushtetutës dhe konform interesave të vendit tonë.

Unë ju ftoj edhe një herë që këtë projektrezolutë, të harmonizuar, ta votojmë kështu si është.

Nëse ndërhyjnë Qeveria, atëherë kjo nuk do të jetë më projektrezolutë e propozuar nga Kuvendi, nga deputetët dhe nga grupet parlamentare. Edhe një herë po e theksoj, e kemi shkruar në prezencën e të gjitha grupeve parlamentare dhe të shefave të grupeve dhe nuk po e kuptoj pse është vonuar nota e protestës, sepse edhe më tutje, deri sa po zhvillohet ky debat, zoti Haradinaj po vazhdon të mbahet në Slloveni. Pasaporta e tij vazhdon të jetë e konfiskuar dhe kjo vazhdon të jetë fyerje, jo vetëm për të personalisht, por për gjithë Kosovën dhe për qytetarët e saj.

KRYETARI: Jam në një pozitë, realisht, shumë të vështirë si kryesues. Por, po dal si deputet dhe unë do ta them fjalën time dhe le të vepron kush çka do.

Kërkoj shumë falje, që më duhet të dal në këtë formë.

Realisht, së pari, ende nuk e kemi një projektrezolutë që të na jepet ne deputetëve ta shohim.

Unë e kam shqetësimin real. Në momentin që evitohet problemi, ku qëndron burimi, është Republika e Serbisë, që ka ngritur për ne shumicën aktakuza të paqena.

Ne mund ta bartim në këtë rezolutë që Qeveria e Republikës së Kosovës, të mbajë edhe qëndrimin në dialog dhe për të mos vazhduar më tej, për t'u futur në këtë rezolutë në mënyrën që të mos ketë manipulime të tilla.

Unë nuk jam assesi të barten te një vend mik ta kalojmë konfliktin e t'i ikim problemit i cili është burimor e është Republika e Serbisë.

Kjo është vetëm arsyeja, për arsye se në momentin kur e dërgojmë një notë proteste, ata do të thonë, ata të cilët e dinë, që ka këtu shumë shokë të luftës dhe janë bashkëluftëtarë se në Morinë, na kanë thënë autoritetet shqiptare: mos u futni me pasaportë pa treguar se policët e thjeshtë nuk po e dinë. Tregoni paraprakisht mënyrën që të mos u futim në sistem, në momentin që futeni në sistem ata janë të obliguar të procedojnë në bazë të Interpolit. E ne po flasim, këtu e kemi Republikën e Shqipërisë e ne po flasim për Republikën e Sllovenisë, që ka pasur kontribut këtu te ne, ka kontribut dhe nuk është mirë ne me shkua vetëm me notë proteste, për arsye se aleatët e Serbisë çdo ditë do të na vënë në momente që të shkojmë me notë proteste, e edhe SHBA-së ne do t'i dalim me notë proteste një ditë. Kjo është e gjitha, e votoni. Por do të ishte mirë, kryetar kisha kërkuar nga ju që t'i kemi vetëm 3 minuta për ta parë rezolutën, deputetë dhe pastaj të votojmë. Pra, vetëm ta shohin për 3 minuta deputetët. Kërkoj falje!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Unë mendoj se tekstin e rezolutës jemi të detyruar që ta shohim dhe ta votojmë tekstin, e jo deklaratat. Atëherë, meqenëse po zhvillohet kështu, ia jap edhe një herë ministrit të Jashtëm dhe zëvendëskryeministrit fjalën dhe pastaj vazhdojmë. Zoti Thaçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Vetëm të kemi të qartë diçka. Ne të gjithë pajtohemi për të nxjerrë rezolutë, por në të njëjtën kohë duhet të sqaroj diçka, edhe para juve deputetë të nderuar, sepse e dini të gjithë, por edhe para opinionit publik, ne nuk kemi problem me vende veç e veç, ne tash nuk mund ta linçojmë raportin tonë me Hungarinë, me Slloveninë apo edhe me ndonjë vend tjetër, me Rumaninë. Nuk është problemi bilateral në këtë rast, është direkt me Interpolin, apo direkt nga Serbia. Problemi qëndron në Beograd, jo në Lubjanë. Faleminderit ! Do të jem vazhdimisht në dispozicion të vazhdimeve. Prandaj, e nxjerrim rezolutën, le ta shikojmë dhe nuk pretendon Qeveria në asnjë rrethanë të ndërhyjë, por ajo çka ne e kemi obligim është që t'i ruajmë relacionet me shtetet mike sepse Sllovenia edhe e ka mbështetur fuqishëm çlirimin e Kosovës, ka qenë pjesë e të gjitha mekanizmave ndërkombëtarë në Kosovë pas luftës dhe në të njëjtën kohë edhe sot është mbështetëse e angazhimeve evropiane të Republikës së Kosovës. Është një nga shtetet më të fuqishme investuese në Republikën e Kosovës, është në rrethanë pak më e gjerë se sa në një kuptim shumë të ngushtë. Prandaj edhe një herë ritheksoj, do të ishte me interes që të ndahet kjo çështje në raport bilateral me këtë shtet apo me atë shtet. Ne e përmendim edhe më herët, e njëjta listë është edhe në listën e kompjuterëve edhe në Bllacë me Maqedoninë, edhe në Jazhincë, edhe në Morinë, edhe në Han të Hotit, apo kah do që shkojmë, prandaj çka nëse ndodh nesër, përsëri po them, në Shqipëri, në Maqedoni apo diku tjetër. Faleminderit shumë!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Po, Donikë, le ta marrë fjalën Ismeti, se e ka kërkuar fjalën si shef i Grupit Parlamentar?

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Ne dolëm dhe e harmonizuam një tekst. Nuk po them që është më i miri dhe që s'kishim mund edhe shumëçka ta shtimë në të, por po ju lus, ashtu sikur që u morëm vesh, pa asnjë problem, nuk po domi t'ia mohojmë askujt të drejtën për ta parë, u lexua ai tekst dhe s'keni çka për ta parë aty, veç keni për ta parë të shkruar dhe ua sjellim, merreni tekstin dhe po them nuk është këtu ndonjë raport me Slloveninë, por në Slloveni disa herë po ndodhin këto raste dhe është një rezolutë, unë mendoj, s'po them e balancuar, por ka edhe kërkesa, ka edhe shqetësime të adresuara, qoftë karshi shtetit slloven, karshi Brukselit, karshi Serbisë përmes Brukselit në një mënyrë dhe kërkesa karshi institucioneve tona.

Unë nuk po shoh për çfarë ne tash duhet të bëjmë debat për diçka që mendoj është një rezolutë që i plotëson kushtet për të shprehur edhe një herë shqetësimin dhe revoltën tonë në një mënyrë për atë që ka ndodhur, jo hera e parë, në Slloveni. Kaq.

KRYETARI: Urdhëro, Donika!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Për procedurë po dua të sqaroj, e tha edhe kolegu Ismet Beqiri. Besoj që edhe tjerë shefa të grupeve parlamentare do ta konfirmojnë. Ne, pas harmonizimit e kemi proceduar në administratë dhe është çështje minutash kur do t'u prezantohet deputetëve.

Dhe e dyta. Ajo çfarë u lexua, është origjinali. Janë tri rekomandime të cilave siç e thamë u drejtohem institucioneve relevante - Qeverisë sonë, sepse ne jemi Kuvend dhe duhet të kërkojmë nga Qeveria veprime, edhe përmes Brukselit t'i bëhet presion Serbisë. Është e theksuar shumë shqip, shumë saktë dhe nuk ka nevojë për të bërë debate të mëtejshme, përveç nëse doni të ndërhyjni, e kjo nuk është korrekte se megjithatë ne jemi deputetë, jemi Kuvend.

Unë po ju thërras kryetar që ta sillni për votim ashtu siç jemi dakorduar të gjithë deputetët e këtij Kuvendi dhe pastaj vendoset me votë se a do të kalojë a jo.

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Mos e merrni këtë edhe si ndërhyrje, sepse megjithatë ne duhet të mendojmë për interesat e Kosovës dhe me bashkëpunimin me vendet mike.

Unë kam biseduar me kryeministrin e Sllovenisë, me zotin Cerar, për këtë çështje. Ai e ka shpjeguar situatën në të cilën janë ndodhur organet ligjore sllovene dhe përpjekjet e tyre që t'i ndërmarrin të gjitha masat që kjo çështje të zgjidhet. Kemi biseduar po ashtu edhe për nevojën që të spastrohen listat, mirëpo të një procedure ligjore sepse duhet të bëhen në pajtim me Interpolin dhe pastrimi i këtyre listave dhe të mos ndodhë më tutje kjo në kufi.

Ata konsiderojnë se çështja është bërë në mënyrë ligjore, sepse në momentin e kontrollit në kufi është dhënë sinjali se është një kërkim nga Interpoli dhe një fletë-arrest i cili është dhënë nga Serbia dhe ajo nuk mohohet, por në këtë rast unë nuk shoh asnjë arsye që ne tash duhet të bëjmë notë proteste ndaj Sllovenisë, sepse ne duhet të kërkojmë që problemi të zgjidhet dhe problemi të zgjidhet në marrëveshje ndërkombëtare në Bruksel, në mënyrë që të mos ketë më tutje raste të tilla dhe që të eliminohet çdo mundësi. Ndërkaq, të apelojmë të gjithë që zoti Haradinaj të kthehet sa më shpejt, e unë këtë apel e kam bërë edhe sot në bisedë telefonike me kryeministrin

slloven dhe do të angazhohemi maksimalisht që kjo çështje të zgjidhet, mirëpo duhet të kemi parasysh se është fjala për një shtet me të cilin kemi një bashkëpunim të thellë ekonomik dhe bashkëpunim shtetëror dhe se këto relacione ne duhet t'i mbajmë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Donika, urdhëro!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Unë vetëm po insistoј ashtu siç e thotë edhe Rregullorja e Kuvendit dhe ligjet në fuqi, që të silltet për votim dhe atëherë deputetët kanë mundësi që të japin deklarime të tyre nëpërmjet votës.

KRYETARI: Më lejo, të bashkëbisedojmë, Donikë. Je parashtruese e mocionit. Kështu, a dëshironi të shkoni me të gjithë projektrezolutën në votim, apo pikë për pikë?

(Ndërhyrje)

Me të gjitha doni, a? Përnjëherë! OK! Unë dy pikat e para, i votoj gjithsesi personalisht por pikën e tretë nuk e votoj. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Ta kemi një zgjidhje elokuede për këtë situatë dhe t'i sqarojmë pak konceptet. Nota e protestës nënkupton qëndrimin zyrtar të Republikës së Kosovës në shenjë proteste ndaj Qeverisë së Sllovenisë, ndërsa, në fakt, gjuha juridike, e cila duhet të përdoret është notë verbale, qëndrim zyrtar se si Qeveria e Kosovës dhe shteti i Kosovës e sheh rastin dhe raste të ngjashme me këto, dhe jo për të protestuar ndaj Sllovenisë, por për ta njoftuar për rastin dhe mendoj që nëse vendoset fjala – 'notë verbale', çështja rregullohet dhe mund të jetë e kalueshme.

Nota verbale nënkupton qëndrimin zyrtar dhe vlerësimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për rastin konkret dhe për rastet e ngjashme që të merren në konsideratë që bashkërisht edhe me Republikën e Sllovenisë, në të ardhmen të shihet mundësia e eliminimit të këtyre problemeve.

Është komunikim zyrtar dhe komunikimin që na e tha kryeministri dhe presidentja që i ka bërë më herët, po me siguri edhe ministri i punëve të Jashtme, janë komunikime zyrtare, por jo diplomatike. Duhet t'i dërgohet në formë diplomatike notë verbale Qeverisë së Sllovenisë dhe në bazë të kësaj note verbale Qeveria e Sllovenisë është e njoftuar për këtë çështje dhe ka bazë edhe për komunikime tjera.

Prandaj, mendoj se mund ta zbusim pak gjuhën dhe të jemi pak korrekt edhe në aspektin e raporteve me Qeverinë e Republikës së Sllovenisë. Faleminderit!

KRYETARI: Donika, a po e merrni fjalën, meqenëse jeni parashtruese, se pastaj janë 11 deputetë dhe po hapet debat i panevojshëm. Për atë, desha t'ia jap fjalën Ilirit, por kjo ishte arsyeja që ta kufizoj këtë.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Edhe një herë po theksoj që pas debateve këtu, si grupe parlamentare jemi harmonizuar dhe e kemi nxjerrë këtë projekt- propozim për rezolutë për të cilën kërkoј dhe këmbënguli dhe duke u bazuar në Rregulloren, dëshiroј ta shfrytëzoј të drejtën

time dhe të sillet si e tillë pa asnjë ndryshim para këtij Kuvendi dhe par kësaj seance. Kështu jemi dakorduar dhe jemi marrë vesh me shefat e grupeve parlamentare, e kemi lexuar para deputetëve, do ta keni për 2, 3 minuta ose po i lexoj edhe një herë pikat një nga një dhe ju thërras që ta votoni dhe atëherë deputetët le të vendosin. Kjo nuk është çështje që negociohet, që ndryshohet, që zbutet, që forcohet, është çështje e cila vendoset me votën e deputetëve dhe të Kuvendit.

Edhe një herë, dëshiroj të theksoj, se është e papranueshme që Qeveria të ndërhyjë në rezolutë dhe në tekstin e një projektrezolute të Kuvendit. Ju kisha lutur që ta ndalim debatin dhe ta sillni për votim.

KRYETARI: Atëherë, përgatituni për votim. Grupet parlamentare e kanë harmonizuar tekstin dhe gabim apo pa gabim, mbajnë përgjegjësi grupet parlamentare dhe deputetët le të votojnë në mënyrë individuale.

Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të projektrezolutës. Dëgjoni, mirë e ka Donika, gabimin e bartin ata që e kanë formuluar dhe deputetët që tash vendosin. Nëse ka gabim në propozim, i kemi zgjedhur vetë shefat e grupeve parlamentare. Përgatituni për votim. Enver, Adem, të lutem! Donika, lexoje edhe një herë, se në ndërkohë jemi duke votuar.

Donikë, lexoje edhe një herë se kanë vërejtje se nuk e kanë lexuar si janë marrë vesh. Lexoje Donika. Unë nuk do të marr më përgjegjësi! Përkundrazi, ju kërkoj falje si kryetar i Kuvendit. Janë marrë vesh për këtë grupet parlamentare dhe urdhëro, Donika, lexoje si jeni marrë vesh.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Edhe një herë po e konfirmoj që kjo projektrezolutë ka dal si harmonizim i grupeve parlamentare, të gjitha subjekteve të përfaqësuar në këtë Kuvend dhe edhe një herë po e theksoj që nuk është në rregull që Qeveria në mes të votimit të këtij dokumenti të ndërhyjë.

Tri pikat për të cilat ne jemi dakorduar, janë si në vijim:

1. Qeveria dhe presidentja e Kosovës urgjentisht të kërkojnë nga autoritetet sllovene që deputetit të Kuvendit të Kosovës, ish kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, tani deputet, i Kuvendit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, pa asnjë kusht dhe menjëherë t'i kthehet pasaporta diplomatike dhe t'i lejohet kthimi në Kosovë.

2. Qeveria e Kosovës të kërkojë urgjentisht nga Brukseli pastrimin e menjëhershëm të listave, respektivisht të fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia për ish-ushtarët e UÇK-së, dhe

3. Drejtimi i notës së protestës shtetit slloven nga institucionet e Kosovës.

Pra, edhe një herë, dhe pa asnjë debat tutje sepse po e shkelim Rregulloren, ju ftoj që ta procedoni për votim dhe do të mbetet në integritetin e të gjithë deputetëve të këtij Kuvendi që të vendosin me votën e tyre pro ose kundër.

KRYETARI: Donika e tha në mënyrë shumë të ashpër, por në mënyrë më të butë! Të përgatitemi për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të projektrezolutës, të cilën e lexoi Donika Kadaj-Bujupi dhe votojmë tash:

58 deputetë kanë votuar. 51 janë për, 7 abstenime.

Pra, përkundër vullnetit tim, kam votuar për, duke i falënderuar qëndrimin të Adem Grabovcit dhe hera e fundit do të jetë, e pastaj do të mbaj qëndrim si deputet, vetë.

Pra, janë 58 vota, 51 për dhe 7 abstenime, prandaj nuk kalon projektrezoluta.

Me këtë, përfundoi seanca e jashtëzakonshme. A dëshironi të shkojmë në pushim të drekës apo të vazhdojmë menjëherë?

Donika, a doni të votohet edhe një herë, se po thoni s'ka pasur kuorum. Pra, a dëshironi edhe një herë të votoni?

(Ndërhyrje)

Atëherë, bëhuni gati edhe një herë të votoni. Tash janë 80 veta në sallë dhe këtë ta keni parasysh. Mirë është edhe publiku ta shohë seriozitetin tonë, do të votojmë edhe një herë.

Urdhëro, Zafir, në ndërkohë, deri të bëhen gati, merre fjalën dhe sqarojeni ju këtë, sepse e sqaroni mirë.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqë isha unë që e përfaqësoja Grupin e Nismës është e vërtetë dhe befasi e këndshme se të gjithë kemi qenë unikë, mirëpo këtu disa nga zërat, duke buruar fillimisht nga Qeveria tentojnë që me këtë rezolutë ta krijojnë një përshtypje se ne duam ta prishim miqësinë me Slloveninë. Nuk është ideja që ne, duke pasur pikën e tretë ne t'i ngrijmë marrëdhëniet, t'i prishim miqësitë. Ideja ka qenë edhe kur e kemi debatuar, do të thotë përfaqësuesit e partive politike, një reagim sepse në Slloveni po ndodhë shpesh. Notë procese, notë verbale, për mendimin tim, nuk është shumë e rëndësishme, sa është një tërheqje e vërejtjes.

Pika e parë, është shumë e rëndësishme dhe unë kam insistuar edhe te Ademi edhe te Ismeti, të konsultohemi edhe me shefat, sepse jemi të interesuar të kemi rezolutë për këtë çështje. Me gjasë Ismeti e ka bërë, Ademi jo.

Problemi është se, meqë kemi qëndrimet nga më të ndryshmet rreth bisedimeve, nuk e kemi përmendur datën 23. Përndryshe, pika e parë nënkupton që kjo çështje duhet të trajtohet në bisedimet në Bruksel, më 23 të këtij muaji. Dhe unë jam i mendimit se duhet të votohet kjo dhe tash gjithsesi dy subjekteve në Qeveri u duhet më shumë konsulta që kur të thonë një herë po edhe të mbetet po. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! A ka nevojë edhe një herë ta lexojmë projektrezolutën, për çdo rast. Jo, s'po bëj shaka, por ka diçka që mund të mos e kanë dëgjuar.

Atëherë, përgatitemi për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të projektrezolutës. Votojmë tash!

Atëherë, i kemi 73 deputetë të cilët kanë votuar. 65 janë për, 8 kanë abstenuar dhe asnjë nuk është kundër. Rezoluta aprovohet! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*